



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë **16.01.2025**

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 13.01.2025, të parashtruar nga Grupi O. E. TALA ENGINEERING_SH.P.K_ & CONSTRUCTION GROUP SHPK & MUHARREM HOTI B.I., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja e ndriqimit publik në Qytet dhe Fshatra, me Nr. të Prok: 613-24-7288-2-1-1nxjerr:

V E N D I M

I Refuzohet, kërkesa për ri-shqyrtim e Grupi O. E. TALA ENGINEERING_SH.P.K_ & CONSTRUCTION GROUP SHPK & MUHARREM HOTI B.I të dt. 13.01.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja e ndriqimit publik në Qytet dhe Fshatra, me Nr. të Prok: 613-24-7288-2-1-1nxjerr:

Vërtetohet Vendimi i AK për shpërblim me kontratë për OE ELEKTRIKA-MONT SHPK Lipjan.

Mbetet në fuqi Vendimi i AK për shpërblim me kontratë i publikuar me datë: 09.01.2025

1. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Grup i Operatorëve Ekonomik e Grupi O. E. TALA ENGINEERING_SH.P.K_ & CONSTRUCTION GROUP SHPK & MUHARREM HOTI B.I të dt. 13.01.2025, lidhur me

aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja e ndriçimit publik në Qytet dhe Fshatra, me Nr. të Prok: 613-24-7288-2-1-1, në këtë aktivitet AK ka shpallur fitues ELEKTRIKA-MONT SHPK Lipjan., **për shpërbllim me kontratë** të datës 09.01.2025, dhe ka publikuar ne platformen elektronike e-prokurimi.

Autoriteti Kontraktues, me datë 16.01.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:
Sa i përket pretendimit të tenderuesit ankues se Raporti i eksperit shqyrtues rekomandon që këtij tenderuesi t’i kërkohen informata shtesë nuk qëndron për arsye se me Vendimet e OSHP-së nr OSHP 2024/0977, të datës 12.12.2024, kjo dhe rrjedhshëm e ka sqaruar ofertën e tenderit ankues Grupi O. E. TALA ENGINEERING_SH.P.K_ & CONSTRUCTION GROUP SHPK & MUHARREM HOTI B.I, në vazhdim po i cekim disa nga arsyetimit pse ky tenderues është i pa përgjegjshëm.

1. Krahasuar me ofertat e tjera ka çmim jo normalishtë të ulët sepse nga gjithsejt 92 pozicione vetë 4 pozicione ka çmime që mund të quhen çmime të tregut, ndërsa 88 të tjera kanë çmime nga 0.10€ që nuk përkojnë aspak me çmimet e tregut. Në fund të këtij vendimi do të keni të bashkangjitur pjesën nga vendimi i OSHP-së. Kjo nuk është arsyeja e vetme pse tenderi në fjalë është shpallur tender i eliminuar sepse tenderuesi në fjalë nuk ka arrit të dëshmojë se ka kryes shërbime të ngjashme të ofrojë dëshmi në vlerë prej 150000.00€ siç është kërkuar në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit. Tenderuesi ankues ka ofruar dëshmi (referenca) vetëm në vlerë prej 50000.00€ të gjitha referencat e tjera nuk i ka për shërbime mirëmbajtje ndriçimit por ndërtim për këtë jepet sqarim edhe në Vendimin e OSHP-së të lartë cekur që edhe kjo pjesë do të jetë e bashkangjitur në fund të këtij Vendimi, ky tenderues është i eliminuar për arsye se nuk e ka plotësuar edhe kushtim për të dëshmuar se të gjithë anëtarët e grupit janë të pajisur me certifikata ISO, sipas kërkesës së AK në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë, e cila situata rregullohet me nenin 26 e RRPP-001/2022 paragrafi 6.
2. Sa i përket pretendimit të dytë se operatori i shpallur fitues nga AK ka çmim jo normalishtë të ulta ky pretendim nuk qëndron për arsye se të gjitha ofertat e pranuar kanë laramani të çmimeve në pozicione të ndryshme dhe krahasuar me ofertën e tenderuesit ankues është më afër çmimeve të tregut. Sa i përket pozicioneve të përmendura nga tenderuesi ankues pozicioni 12 dhe 42 nëse i krahasojmë me disa nga ofertat e pranuar në këtë rast shohim se nuk mund të konkludojmë se janë çmime jo normalishtë të ulta, në vazhdim po i përmendim disa çmime nga tenderuesit për këto pozicione.

nr	tenderuesit	çmimet për pozicionin 12	çmimet për pozicionin 42
1	Grupi O. E. TALA ENGINEERING_SH.P.K_ & CONSTRUCTION GROUP SHPK & MUHARREM HOTI B.I	0.10€	0.10€
	" ETM Group " SH.P.K.Hamdi Grajqevci, Nr.11, FUSHË KOSOVË 601694153	0.05€	0.05€
	ANESI SH.P.K.Gazmend Zajmi Nr 36, prishtinë	0.10€	0.10€
	" ELEKTRIKA - MONT " SH.P.K , Lipjan 810018706	0.10€	0.10€
	TONI INGJINJERING Llapushnik, Magjistrallja, M9, Llapushnik810199861	0.10€	8.00€

	" ELEKTRIKA - MONT " SH.P.K , Lipjan 810018706	2.00€	3.00
	" Item EL " SH.P.K.Rr.Burim Vitia, Prishtinë	2.20€	55.00

Sa i përket pretendimit tjetër se fitues është shpallur nje OE e cila nuk i ka plotësuar kërkesat nga AK tek pika 9.1&9.2 Kapaciteti teknik dhe professional : Inxhinier i diplomuar i Elektroteknikes sistemi 5 vjeçar apo master dega Automatika dhe Elektronika nuk qëndron. Tenderuesi i rekomanduar për kontratë i ka plotësuar këtë kriter duke ofruar dokumentacionin siq është kërkuar në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit ,ndërsa sa i përket moshës së ing që ka kontestohet nga tenderuesi ankues nuk qëndron për arsye se ligji nuk e ndalon për të punuar pas moshës 65 vjet e sidomos për profesionet deficitare siq janë ing.

Sa i perkete pretendimit tjetër ne lidhje me Nenin 7- Barazia ne trajtim/Jo-Diskriminimi dhe transparenca, ky pretendim nuk qëndron për arsye se Autoriteti Kontraktues perkatesishte komisioni i vleresimit konsideron se ka vepruar konforme kerkesave dhe deshmive te kerkuara ne baze te dosjes se tenderit dhe njoftimit per kontrate per kete aktivitet te prokurimit, si dhe duke i'u permbajtur dispozitave ligjore te LPP-se. AK me kete rast konsideron se per kete aktivitet te prokurimit ka nxjerr vendim te drejtë, te arsyeshem dhe meritore duke i'u permbajtur nenit 7, paragrafeve 1, 2 dhe 4 te LPP-se, i cili garanton trajtim te barabarte, jodiskriminues, transparente dhe konkurrues ne mes te Operatoreve Ekonomik.

Sa i përket pretendimit tjetër ne lidhje Neni 59 - Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, edhe ky pretendim nuk qëndron per arsye se Autoriteti Kontraktues ne baze te dispozitave ligjore te LPP-se perkatesishte nenit 59 ka kerkuar sqarime shtese me ane te letrës standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit nga te gjithë Operatoret Ekonomik mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve dhe duke ju përmbajtur dispozitave ligjore te LPP-se ne baze te neni 59 te ketij ligji.

Sa i përket pretendimit tjetër ne lidhje Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës, pretendimi juaj nuk qëndron per arsye se AK ne baze te paragrafit 1.1 te këtij neni ka rekomanduar për kontrate OE me tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët.


AK, konsideron se tenderi juaj është vlerësuar me kujdes dhe ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP.

Drejtori i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.

Bekim Shabani, Drejtor i Drejtorisë së prokurimit





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0977

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga zv.Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Batisha Ibrahim-peneliste individuale duke vendosur sipas ankesës së (OE) "Item EL" SH.P.K., kundër vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të "KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja e ndriçimit publik në Qytet dhe Fshatra" me numër të prokurimit 613-24-7288-2-1-1, me 12/12/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjeserisht e bazuar ankesa e OE "Item EL" SH.P.K. me nr. 2024/0977, e datës 11/10/2024, kurse vendimi i AK "KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN" lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja e ndriçimit publik në Qytet dhe Fshatra" me numër të prokurimit 613-24-7288-2-1-1 anulohet B58 Njoftimi mbi vendimin e AK-se, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik "Item EL" SH.P.K.
4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si pjeserisht e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimin të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "Item EL" SH.P.K., - eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0977 ka vlerësuar si në vijim:

Tenderuesi Ankues, "ITEM EL" SH.P.K. Prishtinë, ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së me datë 04.10.2024, përderisa AK me datë 07.10.2024 ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim. Tenderuesi Ankues, deklaroi se Nuk pajtohet me Njoftimin mbi vendimin e publikuar nga AK- KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN të datë 25.09.2024 dhe PRETENDON se AK, me rastin e vlerësimit të tenderëve dhe të shpalljes së fituesit për këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me Dispozitat e LPP-së dhe me dispozitat e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik.

Eksperti shqyrtues, sipas autorizimit 2024/0977, pas ekzaminimit të tenderit dhe rrjedhës së procedurës së vlerësimit dhe pretendimeve të palës ankuese në ankesë, duke u bazuar në shkresat e lëndës së trajtuar ka konstatuar dhe sqaroi me sa vijon:

PRETENDIMI 1. I TENDERUESIT ANKUES

1.AK ka shkelur nenin 1 dhe 7 të LPP-së pasi që gjatë administrimit me këtë procedurë nuk ka luajtur aspak rol aktiv që shpenzimi i parasë publike të bëhet në mënyrë efikase dhe transparente si dhe nuk i ka trajtuar të gjithë tenderuesit si të barabartë. E themi këtë sepse AK po tenton ta shpërblejë me kontratë një OE i cili edhe pse posedon çmimin më ulët në krahasim me tenderuesit tjerë, i njëjti nuk e plotëson kriterin për projektet e realizuara nga natyra e ngjashme, nuk e plotëson kriterin për stafin e kërkuar, nuk e plotëson kërkesën për ISO certifikatat si dhe posedon pothuajse 95% të çmimeve nëpër pozicione si çmime jo-normalisht të ulëta me vetëm 0.10€. Në bazë të kësaj po shihet se AK e ka favorizuar OE në fjalë dhe e ka shpërblyer me kontratë në kundërshtim me të gjitha rregullat që flasin për vlerësimin e tenderuesve duke u bazuar ekskluzivisht në kërkesat e dosjes së tenderit dhe dispozitat tjera ligjore për përgjegjshmërinë e OE. Nisur nga kjo s'kemi se si të mos mendojmë se AK ka shkelur plotësisht nenin 1 dhe 7 të LPP-së gjatë këtij procesi të vlerësimit përkatësisht përzgjedhjes së fituesit.

1.Përgjigje në pretendimet e lartë cekura (Neni 1, Qëllimi dhe 7 Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminim)

Pretendimi i tenderuesit ankues, se AK, ka shkelur nenin 1 i LPP-së (Qëllimi) është i bazuar, sepse gjatë vlerësimit AK e ka shpallur fitues Tenderuesin e përgjegjshëm Grupi i OE, TALA ENGINEERING SH.P.K. & CONSTRUCTION GROUP SH.P.K. & Muharrem Hoti B.I.

Prishtinë, nuk ju ka përmbajtur këtij Nenin, i cili ka për qëllim të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, të siguroj integritet dhe përgjegjësi gjatë vlerësimit të tenderëve me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji. AK, me rastin e shpalljes së fituesit për këtë kontratë ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP-së, ka bërë favorizimin e ofertës së tij, i cili sipas vlerësimit nga ana ime është i papërgjegjshëm, andaj në këtë rast kemi të bëjë me diskriminimin e tenderuesit ankues.

PRETENDIMI 2. I TENDERUESIT ANKUES

2. AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit nuk i ka respektuar kërkesat e veta nga dosja e tenderit ashtu siç ishin përcaktuar paraprakisht. Neni 59.4 i LPP-së shumë qartë e përcakton se:

Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

E themi këtë sepse shihet e GOE "TALA ENGINEERING SH.P.K.; CONSTRUCTION GROUP SH.P.K.; Muharrem Hoti B.I." nuk i ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit për vlerën e projekteve të ngjashme në vlerën e kërkuar, nuk e ka plotësuar kërkesën për stafin e kërkuar si dhe 95% të çmimeve nëpër pozicione i ka jo-normalisht të ulëta. Tani po pasqyrojmë mangësitë e tilla ofruar pretendimin tonë për mos plotësim të dosjes dhe për secilën mangësi.

Mangësia 1: AK kishte kërkuar që OE të posedoj certifikatat ISO14001-2015, ISO9001- 2015 dhe ISO45001- 2018. Ja si duket kërkesa e AK-së:

2.Përgjigje në pretendimet e lartë cekura (nenin 59-Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve)

Pretendimi i tenderuesit ankues se AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së për Kërkesën 9.1 pika 4 lidhur me certifikatat ISO, është i bazuar sepse tenderuesi i shpallur fitues ka dorëzuar dëshmi për certifikatat ISO 14001-2015, 90001-2015 dhe 45001-2018 vetëm për një anëtarë të grupit të OE (TALA ENGINEERING SH.P.K), por nuk keni dorëzuar fare ISO standardet për dy anëtarët tjerë të grupi të operatorëve ekonomik, "CONSTRUCTION GROUP" SH.P.K dhe "Muharrem Hoti B.P".

Autoritetin Kontraktues – nuk ka vepruar në haermoni të plotë me RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK neni 26.6 Certifikatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim vërtetimin e përputhshmërisë së operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon certifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse.

Lidhur me raste të ngjashme se ky pretendim i tenderuesit ankues është i bazuara janë vërtetuar edhe me vendimet e OSHP-së me NR. 2024/0280, 2024/0188, 2023/1056, 2024/0577, 2024/0551.

Mangësia 2: AK kishte kërkuar që OE të posedojnë stafin e nevojshëm në këtë mënyrë:

Tenderuesi ankues pretendon se ky grup ka paraqitur shihet se kërkesën 2 pika a) nuk ka arritur ta plotësoj asi që sipas referencës shihet se personi në fjalë (Petrir Hajrizi) nuk e posedon eksperiencën e kërkuar prej 5 viteve pas diplomimit

Përgjigje në pretendimet e lartë cekura (mangësia 2- inxhinier i diplomuar i Elektroteknikes menaxheri i kontratës)

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, nuk qëndron, sepse me kontrollimin dhe shqyrtimin e dokumentacionit të dorëzuar nga tenderuesi i shpallur fitues, Autoriteti Kontraktues e ka bërë Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve, në pajtim me neni 59 par. 4 të LPP-së, po citoj: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".për Kapaciteti teknik dhe profesional, për pozitën e kërkuar

Kërkesa 2: Stafin profesional. a) Min Nje inxhinier i diplomuar i Elektroteknikes sistemi 5 vjeçar apo master te caktohet si menaxherit për këtë projekt nga OE, minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Dëshmia e kërkuar dokumentare: Për piken (A dhe B), duhet të dëshmohen me Diplome dhe CV.

Tenderuesi, Grupi i OE, TALA ENGINEERING SH.P.K. & CONSTRUCTION GROUP SH.P.K. & Muharrem Hoti B.I. Prishtinë, ka dorëzuar CV e nënshkruar për menaxherin (Petrir Hajrizi), në të cilën janë dhënë të dhëna të mjaftueshme për përvojën e punës ku janë paraqitur që ka realizuar 83 projekte gjate periudhës prej viti 2009 deri në vitin 2022 si vijon duke i bashkangjitur dhe listuar dëshmi projektet e realizuara, andaj ky pretendim është i pabazuar.

Përpos kësaj mangësie, edhe personi (Xhevdet Rexha) i paraqitur si elektroinstalues nuk posedon certifikatën e trajnimit për elektroinstalues. Certifikata që paraqitur është certifikatë për siguri dhe shëndet në punë andaj nga kjo shihet se edhe kërkesa për 2 elektroinstalues nuk është plotësuar.

Përgjigje në pretendimet e lartë cekura (mangësia 2-teknik e elektros)

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, për një teknik të elektros qëndron, sepse me kontrollimin dhe shqyrtimin e dokumentacionit të dorëzuar nga tenderuesi i shpallur fitues, për Kapaciteti teknik dhe profesional, për pozitën e kërkuar:

Kërkesa 2: Stafin profesional. d) Min 2 teknik te elektros te diplomuar..

Dëshmia e kërkuar dokumentare: Për piken (D) te dëshmohet me diplome.

Tenderuesi, i shpallur fitues, për punëtorin Xhevdet Rexha nuk ka dorëzuar kurrfarë diplome kualifikimi për teknik të elektros si është kërkuar, por ka dorëzuar vetëm një certifikatë trajnimit mbi shëndetin dhe sigurinë në punë e cila nuk e plotësonë kërkesën e AK, andaj ky pretendim i tenderuesit ankues është i pabazuar.

Pretendimi i ankuesit-Mangësia 3: AK kishte kërkuar që OE të kenë projekte të realizuara të ngjashme në këtë mënyrë:

Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (mangësia 3- projekte të realizuara të ngjashme)

Pretendimi i tenderuesit ankues se Tenderi Grupi i OE, TALA ENGINEERING SH.P.K. & CONSTRUCTION GROUP SH.P.K. & Muharrem Hoti B.I. Prishtinë i shpallur fitues nga AK është i papërgjegjshëm, sepse nuk ka dëshmi të mjaftueshme për kërkesën (mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale), nr. i nenit 9.1 & 9.2 pika 1, është i bazuar, sepse nga ekzaminimi vlerësimi i dokumentacionit të dorëzuar me tender, tenderuesi i shpallur fitues i ka prezantuar Listat e kontratave të realizuara, mirëpo listat të cilat i keni prezantuar nuk e përmbush kërkesën e njoftimit për kontratë dhe DT. Ne listën e kontratave të prezantuar nga tenderuesi i shpallur fitues pas ekzaminimit shihet se shuma e kontrata të realizuara për shërbime të ngjashme-mirembajtje dhe ndriqim, nuk e arrin shumen e kërkuar 150,000.00 €, si është kërkuar në njoftimin për kontratë dhe DT, por janë projekte në ndërtim e renovime, si rrjedhojë kjo kërkesë nuk është plotësuar sipas kërkesave në DT dhe NJK, andaj bazuar në UDHËZUESIN Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK-Neni 10, në këto raste refuzohet tenderi:

Pretendimi i ankuesit-Mangësia 4: Kjo mangësi lidhet me çmimet jo-normalisht të ulëta të ofruara nga Grupi i OE i shpallur fitues ku vetëm dy tre artikuj po ti shohësh, vëren dallimin ku çmimi i tregut është deri 500 herë më i lartë se ai i ofruar. Këto çmime ky GOE i ka në të gjitha pozicionet me përjashtim të dy tre pozicioneve nga 92 sa janë gjithsejtë që ka çmime real ose edhe të larta në krahasim me tregun. Këtu po i paraqesim vetëm disa ndërsa të tjerat do i vendosim në pah tek pretendimi i radhës:

1.Përgjigje në pretendimin e lartë çekur (mangësia 4-çmime jo-normalisht të ulëta)

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, se nuk është zbatuar si duhet 61 të LPP-së dhe nenin 41 të Rregullores nr.001/2022 për PP me rastin e vlerësimit të tenderëve (Tenderët Jo-Normalisht të Ulët) nga Autoriteti Kontraktues, është plotësisht i bazuar, sepse në ofertën e Tenderuesit të shpallur fitues, Grupi i OE, TALA ENGINEERING SH.P.K. & CONSTRUCTION GROUP SH.P.K. & Muharrem Hoti B.I. Prishtinë kam konstatuar se kemi të bëjmë me tender jo normalisht të ulët në krahasim me objektin e kontratës dhe krahasimin e çmimeve me ofertuesit tjerë dhe me çmimet e tregut për këtë shërbim, pasi që i përmbush të 3 kushtet si vijon:

Neni 3 Informatat e përgjithshme

3.1 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme;

- i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;
- ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;
- iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

Tabela.nr.1 Eksperti shqyrtues, pas analizës dhe llogaritjes së ofertave financiare të tenderuesve pjesëmarrës, ka konstatuar se AK gjatë vlerësimit të tenderëve nuk ka vepruar në pajtueshmëri me Nenin 61 të LPP-se, të ofertës së Tenderuesit të shpallur fitues, Grupi i OE, TALA ENGINEERING SH.P.K. & CONSTRUCTION GROUP SH.P.K. & Muharrem Hoti B.I. e cila i përmbushin në tërësi të gjitha kushtet ligjore nga neni nenin 41 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik, i përmbush të tri kushtet dhe si rrjedhojë mund të konsiderohet dhe të trajtohet

oferta jo normalisht të ulëta dhe mund të refuzohen si tender jo-normalisht të ulët (shih tabelën nr. 1.).

Eksperti shqyrtues, lidhur me shqyrtimin e pretendimit të tenderuesin Ankues, për të sqaruar më mirë, me qëllim të ardhjes deri te çmimet e përafërta, nga 12 ofertat financiare të pranuar për këto shërbime në këtë aktivitet të prokurimit, ka analizuar dhe kalkuluar çmimet për njësi për të gjitha 12 ofertat e përgjegjshme.

Për të mos u bazuar vetëm në ofertën e tenderuesit ankues, nga 12 ofertat sa kanë ofertuar është nxjerrë Çmimi mesatar për njësi, në Tabelën nr. 2. për 12 oferta si vijon :

Nga krahasimi i çmimeve për njësi, të Tenderuesit të shpallur fitues, Grupi i OE, TALA ENGINEERING SH.P.K. & CONSTRUCTION GROUP SH.P.K. & Muharrem Hoti B.I. dhe mesataren e çmimit të 11 ofertave financiare të tenderuesve pjesëmarrës, kam konstatuar se të gjitha çmimet për njësi të shërbimeve dhe artikujve në listën e çmimeve, janë me çmime jo-normalisht të ulët, krahasuar me Çmimin e fituar mesatar-kolona 5, shumë larg çmimeve për njësi ofertat e tenderëve tjerë pjesëmarrës, të pakrahasueshme. Çmimi total i peshuar i tenderuesit të shpallur fitues, është për 87.59 % nga mesatarja e 11 ofertave prej 287.47 €

Pretendimi i tenderuesit ankues se AK ka shkelur nenin 61 të LPP-së për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët pasi që nuk i ka trajtuar fare çmimet jo-normalisht të ulëta të GOE që e ka shpallur fitues. Ky OE ka ofertuar me çmime spekulative pasi që në disa pozicione ka ofruar çmime jo-normalisht të ulëta (0.10€) ndërsa vetëm në tre-katër pozicione prej 92 sa ishin në total ka ofruar çmime shumë të larta.

Përgjigjësja e ekspertit shqyrtues është se ky pretendim qëndron, sepse tenderi i tenderuesit të shpallur fitues, në shqyrtimin analitik të çmimeve të ofertuara, krahasuar me çmimin e tenderuesve tjerë –mesatarja e çmimeve për 12 oferta pjesëmarrëse kanë ardhur në konstatim dhe përfundim se tenderi tij është jo-normalisht i ulët, nga 92 artikuj 96 % apo 88 artikuj kanë të njëjtin çmim 0.10 € dhe vetëm 4 artikuj kanë (grupi I: vetëm art. 2=35,00€, grupi II: art. 6=5,00€, art. 8=5,00€) kanë çmime abnormalisht të larta të cilat është dashe të vlerësohen të papranueshme për Autoritetin Kontraktues.

Këto çmime të ofertuara (grupi I: vetëm art. 2=35,00€, grupi II: art. 6=5,00€, art. 8=5,00€) bien në kundërshtim me nenin 4 të RRUOP-së pika 4.2 ku kërkohet nga AK si në vijim:

4.2 Gjatë administrimit të procedurave të prokurimit, AK do të ketë obligimet në vijim:

c) të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut.

Autoriteti kontraktues gjatë vlerësimit të këtij tenderi në pajtueshmëri me nenin 61 të LPP-së, ka kërkuar nga tenderuesi i shpallur fitues, për të dhënë shpjegim për çmimet jo normalisht të ulëta, përmes Letër Standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët, si vijon:

Mirëpo përgjigjja e Tenderuesit të shpallur fitues, Grupii OE, TALA ENGINEERING SH.P.K. & CONSTRUCTION GROUP SH.P.K. & Muharrem Hoti B.I. në vijim:

Analiza për vendosjen e çmimeve

Ne kategorinë e pare prej 80 % x 300,000.00 Euro vlere e kontratës, ne këtë kategori mund te paguhen vetëm 240,000.00 euro.

Ne kemi vendosur çmimin prej 35 euro për 1 cope, ku mbulon te gjitha shpenzimet e kompanisë për vendosjen e këtij pozicioni dhe te gjithë kontratës ku plotëson mazhën e fitimit te kompanisë sepse çmim i furnizimit për këta artikuj për ne është 9.60 euro për 1 cope, ndërsa ne kemi vendosur ne paramase çmimin 35 euro I cili është 4 here me i larte se çmimi i furnizimit dhe për ne si kompani është i mjaftueshëm çmimi i kontraktuar.

Ne kategorinë e pare vlere e shpenzimit është 240,000.00 euro e kontraktuar: Vlere e kontraktuar vetëm për 1 drite është 35 euro për 1 cope, $240,000.00 \text{ Euro} / 35 \text{ euro per } 1 \text{ cope} = 6860 \text{ Drita}$ mund te vendosen Shpenzimi i Kompanisë/ Furnizimi $6860 \text{ drita} \times 9.60 \text{ copa} = 65,828.00 \text{ Euro}$ Shpenzim Fuqia punëtorë është shpenzim i rregullet ne kompaninë tone e cila ne baze te llogaritjes është 5 euro 1 cope për montim. $6860 \text{ Copa} \times 5 \text{ euro montimi} = 32925 \text{ Montimi}$ $98,753.00 \text{ Euro shpenzime Diferenca/ Fitimi ne kategorinë e pare } 240,000.00 \text{ e kontraktuar} - 98753.00 \text{ euro shpenzim} = 141,247.00 \text{ euro Fitim},$

Pozicioni tjetër është i vendosur kablo 2 x 16 mm² çmimi i furnizimit është 0.45 Cent, ndërsa çmimi i kontraktuar është 3 euro/ m , i cili nënkupton 6 here me i larte se çmimi i tregut.

Përgjigjen, më lartë lidhur me çmimet Jo-normalisht të ulëta, në pajtueshmëri me Nenin 41 pika 10.b. të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, për ekspertin shqyrtues janë të pamjaftueshme, jo bindëse sepse nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi dhe kalkulim të detajuar, zbrëthim të çmimeve të kërkuar nga AK, me kosto të shërbimeve dhe furnizimeve të materialeve për të siguruar se ka dorëzuar një ofertë të besueshme për AK, kjo përgjigjeje nuk është dashtë të pranohet edhe nga AK.

Në përgjigjeje tenderuesit të shpallur fitues, vet e ka pranuar se çmimet janë jo reale manipulative me çmimet e tregut ku vet thekson, citojmë: (Ne kemi vendosur çmimin prej 35 euro për 1 cope, ku mbulon te gjitha shpenzimet e kompanisë për vendosjen e këtij pozicioni dhe te gjithë kontratës ku plotëson mazhen e fitimit te kompanisë sepse çmim i furnizimit për këta artikuj për ne është 9.60 euro për 1 cope, ndërsa ne kemi vendosur ne paramase çmimin 35 euro) e njëjtë ka deklaruar edhe për 3 çmimet tjera të larta.

Kjo përgjigjeje dhe deklarim bie në kundërshtim me nenin 54 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik për të cilën edhe KRPP-ja ka dhënë interpretimin nr .28, dhe tenderuesi ankues për ti kundërshtuar këto çmime jo normalisht të ulëta e ka paraqitur një analizë për të cilën ka marrë dëshmi dhe shembull interpretimin nr .28 nga KRPP-ja nga

Në pretendimin konstatimin dhe pretendimin tjetër të tenderuesit ankues ka deklaruar:

Buxheti i tërësishëm është 250.000€, ku 80% e tijë ose shprehur në vlerë monetare 200.000€ shkojnë për grupin e parë të artikujve. Kur ta pjesëtojmë këtë shumë për 42 pozicione sepse pasi që e kanë indeksin e njëjtë të pjesëmartjes, ligjërisht dhe sipas interpretimit të KRPP-së i bie që buxheti për një pozicion të jetë 4,761.90€. Me çmimin e ofruar për pozicionin 3 dhe 4 dhe me vetëm 70% të implementimit të kontratës për pozicione sipas përqindjes që është detyrim ligjor për AK-në, i bie që vetëm për njërin nga këto dy pozicione të instalohen nga 33,330 trupa ndriçues. Kur i shumëzojmë ato me çmimin e tregut që nuk mundet të jetë më pak se ai i pozicionit 2, i bie që të nevojitet buxhet prej mbi 1 mln euro. Kjo analizë e thjesht finaciare që

AK e ka detyrim ta respektoj, tregon qartë se sqarimi dhe arsyetimi për çmimet jo-normalisht të ulëta është vetëm mashttrim për opinionin dhe dëmtim të buxhetit për Autoritetin kontraktues.

Eksperti shqyrtues pajtohet me elaborimin dhe analizën e e bërë pa dashur ti përsëriti këto analiza dhe kjo përgjigjeje është dhënë edhe nga KRPP-ja në interpretimin nr 28,

28. 09.06.2023 Në rast të kontratave publike kornizë me çmime njësi, çmimet e peshuara a duhet të realizohen me të njëjtën përqindje (%) gjatë ekzekutimit të kontratës?

Nga gjithë kjo që u tha më lartë, lidhur me Nenin 61 (Tenderët Jo-Normalisht të Ulët), mendoj se është pasojë e vendosjes së Kriterit për Dhënie të Kontratës nga Autoriteti Kontraktues, (Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët i poentuar), pa e analizuar në mënyrë të duhur natyrën e këtij shërbimi.

AK nuk ja ka arritur ta vendos kriterin, në pajtueshmëri me Nenin 52.6. të LPP dhe Nenin 27. të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik (Kriteret e Dhënies së Kontratës), për të mundur me fituar ofertën më të volitshme me çmim më të ulët sipas peshimit. Kjo ka ardhur për arsye AK gjatë hartimit të Paramasës dhe parallogarisë, nuk ka arritur ta bëjë ndarjen duhur të kategorive të shërbimeve, në vendosje e peshës në bazë të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve".

Procedura e poentimit të çmimit nëse nuk bëhet në mënyrë të duhur si me këtë procedurë, ju jep mundësi operatorëve ekonomik që të vendosin çmime të larta në artikujt që ata mendojnë që do të porositen dhe çmime jonormalisht të ulëta në artikujt që ata mendojnë që nuk do të porositen.

Pas këtyre argumenteve të prezantuara përmes këtij raporti, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i tenderuesit ankues, se Autoriteti Kontraktues ka shkelur neni 61 i LPP, pasi nuk e ka bërë vlerësimin në pajtueshmëri me Rregullat për Tenderët Jo- Normalisht të Ulët, janë të bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjera, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Item EL" SH.P.K., dhe se argumentimi në raportin e ekspertit është i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen

përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin “Mirëmbajtja e ndriçimit publik në Qytet dhe Fshatra” me nr. të prokurimit: 613-24-7288-2-1-1 për çka se edhe në përgjigjjet ndaj raportit të ekspertit shqyrtues Autoriteti Kontraktues është pajtuar pjesërishtë.

Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin raportit të ekspertit dhe në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Item EL” SH.P.K., janë pjesërisht të bazuara, dhe ka marur vendim që aktiviteti i prokurimit me “Mirëmbajtja e ndriçimit publik në Qytet dhe Fshatra” me nr. të prokurimit: 613-24-7288-2-1-1 të kthehet në rivlerësim dhe AK gjate vlersimit të veproj në raport me dispozitat ligjore të LPP-së.


Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III,IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP-së

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Batisha Ibrahimi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN
- OE - " Item EL " SH.P.K.
- Arkivës së OSHP-së: